

# Dosjet e dorëzuara, akuza për tjetërsim te të tretët”

2012-03-04

*Bledar Hoti*

“Dosjet e dorëzuara, akuza për tjetërsim te të tretët”

Komisionet e prefektit japin vendime për tjetërsim pronash

*Titujt*

## Regjistrimi i pronave në hipoteka, qytetarët 76 ankesa për tapitë

Avokati i Popullit, në raportin vjetor të vitit 2011, bën prezent vështirësitë dhe problemet që hasin qytetarët në tjetërsimin e pronave. E kjo e ndërmarrë me vendimet e institucioneve shtetërore, siç janë edhe Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjithashtu, Avokati bën të ditur se ankesa ka dhe për AKKP-në, ku nuk zbatohen afatet dhe kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative. Një dukuri tjetër mbetet hermetizmi, zyra dhe dyer që nuk hapen, të mbyllura për komunikim me ankuesit, avokatët dhe përfaqësuesit e tyre. “Avokati i Popullit, gjatë vitit 2011 ka trajtuar dhe 76 ankesa, një numër i konsiderueshëm individësh, me pretendime ndaj Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat me veprimet apo mosveprimet e tyre janë bërë premisë për shkeljen e të drejtës së pronës. Këto organe, në shumë raste nuk janë veçse një pengesë burokratike artificiale ndaj qytetarëve të thjeshtë për kryerjen e veprimeve të ndryshme të parashikuara nga ligji”, - thuhet në raport.

### Ankesa e I

Me ankesën nr. 201101012, qytetarja, pas një kohe relativisht të gjatë jashtë Shqipërie, kërkonte informacion për sasinë maksimale të tokave që njeh, kthen apo kompenson KKKP-ja për trashëgimlënësin e saj, ish-pronar i madh. Ne sqaruam se nëse në nenin 6 të ligjit, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet deri në 100 ha, prona u kthehet pa kufizim.

### Ankesa e II

Për Avokatin problematike është ankesa me nr. 201001390, me të cilën familja ankuese, kreditore, parashtronte pretendimet për zvarritje të pamotivuara në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane të Strasburgut, i marrë në datën 23 korrik të 2007. Në këtë vendim detyrohej KKKP-ja të nxjerrë vendim në formën e kërkuar nga ligji dhe kthimin e një sipërfaqeje trualli, ndërkohë që është ekzekutuar vetëm pagimi nga qeveria shqiptare i dëmit moral. Nga shqyrtimi i rastiit rezulton se ish-AKKP-ja rajonale, me vendimin nr.109, datë 26 gusht 1996, nga prona e kërkuar prej 146 ha ose 1100 vretenësh, u njohu ankuesve sipërfaqen brenda vijës së verdhë të qytetit dhe ktheu 2 ha, sipas kufizimit të ligjit të kohës. Në vendim mungonin tri firmat e anëtarëve të komisionit. Sipas nenit 120 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të korrigjoheshin nga vetë institucioni. Meqë kjo nuk funksionoi, ankuesit iu drejtuan gjykatës. Në kushtet e keqinterpretimit, kreditorja iu drejtua Strasburgut, e cila i dha të drejtë. Por këtu, sipas Avokatit, as nga AKKP-ja dhe as nga Përmbartimi nuk pranohet zbatimi i vendimit të Gjykatës Europiane të Strasburgut

## Hydrocentralet

Avokati shpreh shqetësim dhe në lidhje me kompensimin e pronave të të shpronësuarve nga ndërtimi i HEC-it të Fierzës. Problem mbetet se në këto raste duhet të angazhohet AKKP-ja, veç rasteve ku flitet për trojet industriale. Një rast tjetër është dhe një pronë e një qytetari nga Tirana për truallin në Zall-Herr. Ky truall i është dhënë një pronari privat me qira kundrejt një qiraje në favor të pushtetit vendor, në një kohë prona i është njohur këtij shtetasi. Avokati ngre dhe si shqetësim ankesën e konstatuar në Vlorë, lidhur me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga ana e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, privatizimi i një objekti, ish-mensë e NB-së. Sipas raportit, drejtuesit e kësaj Agjencie e kanë zvarritur në mënyrë të pakuptimtë dhe të pabazuar në ligj zbatimin e titullit ekzekutiv, pa shkaqe ligjore.

## Dokumenti

### Avokati i Popullit prezanton anomalitë e procesit të pronësisë në Shqipëri



Qeveria dhe Kuvendi ndërmarrin vendime antiligjore dhe antikushtetuese për sa i përket procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Ky është vlerësimi negativ që Avokati i Popullit jep nëpërmjet raportit vjetor të depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me procesin e pronësisë në vend. Çështja e pronave, e kthyer në një “makth” për qeverinë duket se ka përfshirë edhe institucionin e pavarur të Avokatit të Popullit, i cili ka ndërhyrë në rregullimin e vakumeve ligjore apo të antikushtetueshmërisë së konstatuar nga VKM-të apo Legjislativi. Në faqen 79 të raportit të Avokatit të Popullit, Igli Totozani bëhet e ditur se pranë institucionit që ai drejton janë paraqitur 221 ankesa me objekt verifikimin apo shkeljen e së drejtës së pronësisë nga veprimet apo mosveprimet e parregullta apo të paligjshme nga organet e administratës publike. Të tilla janë Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale, organet e pushtetit vendor apo Komisionet e Verifikimit të Ligjshmërisë së Titujve të Pronësisë. Pjesa më e madhe e 221 ankesave, sipas raportit, lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit “Për kthimin e kompensimin e pronave” dhe me veprimtarinë e AKKP-së, organi administrativ i ngarkuar me rregullimin sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës, të rivendosjes së një të drejte të shkelur të çështjeve të pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, konfiskimet ose shtetëzimet. Antikushtetutshmërinë e vendimeve të qeverisë dhe të Kuvendit, Totozani e lidh me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Më i fundit është vendimi numër 27 i Gjykatës Kushtetuese, i marrë në datën 26.05.2010, “për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 15, pika 1, germat “c”, “ç”, “d” dhe “dh” dhe neni 16 të ligjit ‘Për kthimin e kompensimin

e pronës”. Këto norma të shfuqizuara kishin të bënin me kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së që mbi bazën e një kërkesë për rishikim të shqyrtonte vendimet e ish-zyrave rajonale të AKKP-së në 12 qarqe, rrethe, apo bashki dhe nëse konstatonte të meta, t’i shfuqizonte ato. “Kuvendi më pas, miratoi ligjin ku drejtorit të AKKP-së i jepej përsëri e drejta për rishikimin dhe shfuqizimin e vendimeve të subjekteve të shpronësuara, për njohjen, kthimin apo kompensimin. Nënvizojmë faktin, që pavarësisht se kërkesa e Komisionit parlamentar të Ligjeve të Kuvendit, drejtuar Avokatit të Popullit për të dhënë vlerësimin e tij paraprak mbi kushtetutshmërinë e këtyre ndryshimeve, mori vlerësim negativ. Kuvendi i miratoi ato”, thuhet në raport. Më tej theksohet se “institucioni i Avokatit të Popullit, asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk do jetë pro shkëlqeve ose deformimeve të çfarëdo natyre qofshin dhe do të reagojë institucionalisht për rivendosjen e të drejtave të cenuara, por gjithnjë me rrugë dhe procedura ligjore”. Pjesa më e madhe e ankesave lidhen me vendimet e AKKP-së. Ka shumë të shpronësuar që ende nuk kanë marrë një vendim për kërkesën e depozituar e protokolluar prej viteve pranë ish-AKKP-ve. Një pjesë e këtyre ankesave janë për kundërshtimin e vendimeve të AKKP-së, që për arsye të ndryshme, nuk i ka njohur aplikuesit si të shpronësuar dhe si të tillë Avokati i ka sugjeruar të ndjekin rrugën gjyqësore.

## Komisionet e prefektit japin vendime për tjetërsim pronash

2012-03-04

[“Dosjet e dorëzuara, akuza për tjetërsim te të tretët”](#)

[Komisionet e prefektit japin vendime për tjetërsim pronash](#)

*Vendorët*

### Probleme: Shpronësimet, legalizimet dhe verifikimi i titujve

Avokati i Popullit ka sjellë në raportin e tij vjetor shqetësimet që kanë qytetarët në lidhje me shpronësimet. “Konkretisht, shkelja vërehet në trajtimin e rasteve të ndryshme në lidhje me moskryerjen e procedurave të shpronësimit, me deklaratimet publike për sipërfaqe të vogla, se sa janë shpronësuar në fakt në terren dhe për vonesa në dhënien e dëmshpërblimit. Në shumë raste njësitë e qeverisjes vendore krijojnë komisione për verifikimin e konflikteve të pronësisë midis personave fizikë dhe mbi ‘ekspertizën’ e tyre marrin vendime, duke marrë dhe kompetencat dhe juridiksionin e pushtetit gjyqësor”, - thuhet në raport. Një numër i konsiderueshëm i ankesave lidhet me vendimet dhe veprimtarinë e Komisioneve Vendore të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë prefektit të çdo qarkut. Krijimi i titujve të rinj të pronësisë solli një fluks ankimesh nga familjet bujqësore, të cilat nuk kanë marrë ende një certifikatë pronësie. Në dy raste ankuesit pretendonin me të drejtë, sipas Avokatit, se Komisionet Vendore, pas mbarimit të afatit të veprimtarisë së tyre, që korrespondon me datën 16 gusht 2011, iu dhanë fund shqyrtimit administrativ të nisur pa u shprehur me vendim përfundimtar për themelin. Kjo bie ndesh me nenin 5 të Kodit të Procedurës Administrative. Pra, nuk është kryer hetimi i duhur dhe nuk është marrë vendimi përfundimtar. Ankesa kanë vijuar edhe pas përfundimit të afatit, për mospasje dijani të këtij fakti nga qytetarët, përfshirë edhe bashkatdhetarë me banim në Itali. Kërkesa ka edhe nga zona të caktuara, si nga banorët e fshatrave të Himarës, nga Komuna Ksamil e tjera. Sipas Avokatit të Popullit, ankesa kanë ardhur edhe nga Shoqata e ish-Pronarëve të tokave në bregdet, për mospërfundimin e procesit të ndarjes së tokave bujqësore të ish-kooperativave bujqësore dhe ish-NB-ve. Ankesat për verifikimin e titujve të pronësisë lidhen me zvarritje të

shqyrtimit të ankesave nga Komisioni që drejtohet nga prefekti, apo ndaj vendimeve për fshirje të pasurive të subjekteve përfitues dhe regjistrimin në emër të të tjerëve pa argumentim.

## “Skemë e pastër mafioze për të na rrëmbyer pronat”

2012-03-04

[Shteti u grabit pronarëve kullotat](#)

[“Skemë e pastër mafioze për të na rrëmbyer pronat”](#)

[Nga britanikët, deri tek azerbajxhanasit, interes për të blerë tokat me para në dorë](#)

*Ankesa*

### Gëzim Kuçuku, përfaqësues i shoqatës: AKKP po mban peng dosjet tona

Pronarët e kullotës hedhin dyshime të forta se “dikush” fshihet pas vendimit të fundit të qeverisë, për t’ia kaluar pronën Bashkisë së Konispolit. Gëzim Kuçuku, përfaqësues i “Shoqatës Pronarët e Konispol- Stil”, tregon për “Shqip” ecejaket në korridoret e institucioneve shqiptare.

*Pas njohjes nga gjykata dhe Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vitin 1999, pse hipoteka, sipas jush, nuk e regjistron pronën e njohur ligjërish?*

Arsyet janë nga më të ndryshmet dhe absurde. Hipoteka pretendonte që nuk i kishin shkuar për dijeni vendimet e komisionit të pronave, dhe më pas gjeti pretekste për ndarjen e pronës. Hipoteka insistonte nga ne që këto prona në bashkëpronësi të copëtoheshin, të ndaheshim midis nesh, por nuk ishim dakord, pasi humbnin funksionin si kullota, dhe aq më tepër nuk kishte arsye ligjore që ta ndanin tokën, pasi dhe vetë kapitulli i “bashkëpronësi” në Kodin Civil nuk e detyron këtë gjë.

Loja ndaj nesh nga hipoteka vijonte me muaj të tërë, ku pas zvarritjeve të shumta, më pas bënte presion se do gjobiteshim në rast se nuk e regjistronin pronën me kushtet që kërkonte ky institucion.

*Kanë kaluar më shumë se 10 vjet. Hipoteka vijon të mos e regjistrojë pronën?*

Jo, ende, për arsyet e lartpërmendura. Kemi pasur raste që bashkë me përmbarimin, i cili e denoncoi rastin në prokurori, të kërkojmë të drejtën tonë, por sërish hipoteka nuk e regjistron, paçka se kemi dokumentacion të rregullt. Së fundmi me VKM, krejt papritur, qeveria e ka kaluar kullotën në pronësi të Bashkisë së Konispolit.

*Pse erdhi ky vendim, çfarë fshihet pas tij, ku dyshoni?*

Ky vendim është një tjetërsim i pastër prone, veprim antikushtetues (neni 41) dhe ligjor (neni 195, Kodi Civil). Me kalimin e tokave tona si pronë e Bashkisë së Konispolit, këto kullota kthehen si asete të shtetit, i cili ka të drejtë kurdoherë dhe kujtdo t’ia shesë, me çmime qesharake për interesa të ngushta politike etj. Ka pasur vendime të posaçme për shitjen e tokave në këtë zonë për 56 lekë metri katror, sa një kafe, dhe kështu do të veprojnë dhe me tokat tona, tashmë nën administrimin e bashkisë.

*Një pjesë e kullotës preket nga bregdeti. A keni dyshime që gjithë këto manovra bëhen për qëllime interesi të dikujt?*

Patjetër që për këto toka ka interes nga dikush që ende nuk e ka nxjerrë kokën në dritë, por pret momentin e duhur për ta blerë, siç thashë më lartë me çmim qesharak. Pra, po manovrohet si skemat e një mafie të vërtetë dhe ne jemi të pafuqishëm për të fituar të drejtën tonë themelore që na e jep ligji. Për këtë arsye zvarritet dhe regjistrimi i pronave. AKKP mban peng vendimet e komisioneve që na kanë njohur tokën, dhe nuk merr asnjë masë për ta na e kthyer atë.

*E keni njohur ministrin e Drejtësisë me këtë çështje?*

Dosjen tonë të pronave e njuh si ministri i mëparshëm i Drejtësisë, Bujar Nishani, sot ministër për pushtetin lokal, që ka firmosur vendimin nr.17, datë 04/01/2012, e njuh ministri aktual, Eduard Halimi dhe kryeregjistruesi, Arben Qirjako, sikurse dhe ministri i Mjedisit, Fatmir Mediu, por të gjithë janë treguar indiferent ndaj nesh, duke mos na kthyer përgjigje.

*Në këto kushte, si do të veproni për zgjidhjen e problemit?*

Nëse këto institucione nuk veprojnë, ne do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, ku kemi besim që do të korrigojë këtë shkelje kushtetuese.

## Shteti u grabit pronarëve kullotat

2012-03-04

[Ard Kola](#)

[Shteti u grabit pronarëve kullotat](#)

["Skemë e pastër mafioze për të na rrëmbyer pronat"](#)

[Nga britanikët, deri tek azerbajxhanasit, interes për të blerë tokat me para në dorë](#)

*Konispol*

### Beteja 14-vjeçare për 3400 ha tokë të 129 familjeve. Dyshime mbi pjesën në bregdet

Shteti ua mori më 1944 dhe sërish po shteti po ua merr më 2012-n. Nëse rasti i parë justifikohet për faktin se shteti sapo ishte krijuar dhe kishte nevojë për një menaxhim më të koordinuar, rasti dytë nuk ka motiv, por thjesht interesa të caktuara nga "të fortët" e pushtetit. Në kushtet kur qeveria duhet të plotësojë një nga 12 kriteret e përcaktuara nga BE, si rruga drejt anëtarësimit, që është zgjidhja e çështjes së pronës, merren vendime në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën, duke hapur të tjera fronte "lufte" me ish-pronarët.

Aktualisht, procesi i kthimit dhe kompensimit ka hyrë në një rrugë pa krye, ku shumë pak pronarë kanë fituar të drejtën e tokës, apo janë kompensuar financiarisht, ndërsa firmat e huaja vijnë dhe shkojnë me zhgënjimin e mosgjetjes së pronarit të duhur ku do të investojnë.

Në kulmin e debatit mbi pronën, qeveria ka marrë së fundi, në janar 2012, krejt papritur një vendim me nr.17, duke ia kaluar kullotat në pronësi Bashkisë së Konispolit, në kushtet kur ka pronarë të ligjshëm mbi këto toka. Bëhet fjalë për një pasuri të rrallë, prej 3400 hektarësh, që shtrihet nga kanali i Butrintit dhe zbret deri në kufi me Greqinë, dhe ku një pjesë prek edhe bregdetin. Tokat u përkasin 129 familjeve, pronarë që në kohën e Zogut, të dokumentuar nga arkiva e shtetit dhe të fituar me të drejtë më 1999-n, me vendim gjyqi dhe më pas, të njohur nga

komisioni rajonal i kthimit dhe kompensimit të pronës. Këtu nis dhe kalvari i përplasjeve me burokracinë e shtetit. Një pjesë e pronarëve, mundën ta fitonin të drejtën në Agjencinë e Kthimit të Pronës, e cila dha vendime për 37 familje, për sipërfaqe kullote 1700 hektarë, ndërsa të tjerat ishin në proces. Kullota është e ndarë me parcela, sipas kufirit natyror dhe është shfrytëzuar nga çobanët, kundrejt qirasë së paguar në shtet.

Përfaqësuesit e familjeve thonë se pavarësisht se gjykata dhe komisioni u ktheu pronën, sërish subjekte të ndryshme, me leje të Ministrisë së Mjedisit i zaptuan tokat për qëllime të ndryshme. Problemi qëndron në faktin që për t'u bërë pronar tërësisht i ligjshëm, nevojitej regjistrimi i pronës në hipotekë. Pas vendimit në gjykatë dhe vendimit të komisionit të pronave në '99-n, familjet iu drejtuan zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si hallka e fundit për marrjen e certifikatës. Hipoteka nuk i regjistron pronat, duke i zvarritur me pretekste të ndryshme, kur në fillim thoshte që ende nuk ishte njohur me vendimin e komisionit të kthimit, dhe më pas u kërkonte 129 familjeve bashkëpronare të 3300 ha kullota që të ndanin kufijtë me njëri-tjetrin.

Për 14 vjet, pronarët janë përplasur si me hipotekën, ashtu dhe me agjencinë e kthimit të pronave (AKKP-së në Tiranë). Për këtë të fundit shprehim mjaft ankesa, pasi justifikimi i zyrtarëve të kësaj agjencie ka qenë ndër më absurdët, ku shpeshherë thoshin "që nuk kemi kohë".

Sikur të mos mjaftonte kjo betejë, qeveria merr një vendim, që tokat e këtyre familjeve ia kalon në pronësi Bashkisë së Konispolit dhe tashmë kjo njësi ka të drejtën t'i shesë apo t'i japë me qira.

"Mendohet se në këtë mënyrë, Bashkia e Konispolit pasi t'i regjistrojë këto prona, do t'i nxjerrë për shitje, të cilat do t'i blejnë ata që kanë nxjerrë dhe këtë VKM Nr.17 dt.04/01/2012, që çuditërisht atë ditë nuk ka pasur mbledhje qeverie. Kjo mund të quhet mënyra moderne e grabitjes së pronave", thotë shoqata e "Pronarëve Konispol-Stil".

Pronarët druajnë se tokat e tyre do të përfundojnë në pronësi të dikujt tjetër, me çmime qesharake, si rasti i shpronësimit të rrugës Sarandë-Kranë-Konispol, për 56 lekë metri katror. (faqja 8307 e (Fletores Zyrtare). Tashmë me vendimin në dorë, Bashkia e Konispolit ka të drejtën të bëjë çfarë të dojë me tokat, vendndodhja e të cilave konsiderohet një aset me shumë vlerë, pasi prek një pjesë të rivierës joniane dhe e shtrirë mes maleve.

## Shteti u grabit pronarëve kullotat

2012-03-04

*Ard Kola*

Shteti u grabit pronarëve kullotat

"Skemë e pastër mafioze për të na rrëmbyer pronat"

Nga britanikët, deri tek azerbajxhanasit, interes për të blerë tokat me para në dorë

*Konispol*

### Beteja 14-vjeçare për 3400 ha tokë të 129 familjeve. Dyshime mbi pjesën në bregdet

Shteti ua mori më 1944 dhe sërish po shteti po ua merr më 2012-n. Nëse rasti i parë justifikohet për faktin se shteti sapo ishte krijuar dhe kishte nevojë për një menaxhim më të koordinuar, rasti dytë nuk ka motiv, por thjesht interesa të caktuara nga "të fortët" e pushtetit. Në kushtet kur



qeveria duhet të plotësojë një nga 12 kriteret e përcaktuara nga BE, si rruga drejt anëtarësimit, që është zgjidhja e çështjes së pronës, merren vendime në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën, duke hapur të tjera fronte "luftë" me ish-pronarët.

Aktualisht, procesi i kthimit dhe kompensimit ka hyrë në një rrugë pa krye, ku shumë pak pronarë kanë fituar të drejtën e tokës, apo janë kompensuar financiarisht, ndërsa firmat e huaja vijjnë dhe shkojnë me zhgënjimin e mosgjetyes së pronarit të duhur ku do të investojnë.

Në kulmin e debatit mbi pronën, qeveria ka marrë së fundi, në janar 2012, krejt papritur një vendim me nr.17, duke ia kaluar kullotat në pronësi Bashkisë së Konispolit, në kushtet kur ka pronarë të ligjshëm mbi këto toka. Bëhet fjalë për një pasuri të rrallë, prej 3400 hektarësh, që shtrihet nga kanali i Butrintit dhe zbret deri në kufi me Greqinë, dhe ku një pjesë prek edhe bregdetin. Tokat u përkasin 129 familjeve, pronarë që në kohën e Zogut, të dokumentuar nga arkiva e shtetit dhe të fituar me të drejtë më 1999-n, me vendim gjyqi dhe më pas, të njohur nga komisioni rajonal i kthimit dhe kompensimit të pronës. Këtu nis dhe kalvari i përplasjeve me burokracinë e shtetit. Një pjesë e pronarëve, mundën ta fitonin të drejtën në Agjencinë e Kthimit të Pronës, e cila dha vendime për 37 familje, për sipërfaqe kullote 1700 hektarë, ndërsa të tjerat ishin në proces. Kullota është e ndarë me parcela, sipas kufirit natyror dhe është shfrytëzuar nga çobanët, kundrejt qirasë së paguar në shtet.

Përfaqësuesit e familjeve thonë se pavarësisht se gjykata dhe komisioni u ktheu pronën, sërish subjekte të ndryshme, me leje të Ministrisë së Mjedisit i zaptonin tokat për qëllime të ndryshme. Problemi qëndron në faktin që për t'u bërë pronar tërësisht i ligjshëm, nevojitej regjistrimi i pronës në hipotekë. Pas vendimit në gjykatë dhe vendimit të komisionit të pronave në '99-n, familjet iu drejtuan zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si hallka e fundit për marrjen e certifikatës. Hipoteka nuk i regjistroi pronat, duke i zvarritur me pretekte të ndryshme, kur në fillim thoshte që ende nuk ishte njohur me vendimin e komisionit të kthimit, dhe më pas u kërkonte 129 familjeve bashkëpronare të 3300 ha kullota që të ndanin kufijtë me njëri-tjetrin.

Për 14 vjet, pronarët janë përplasur si me hipotekën, ashtu dhe me agjencinë e kthimit të pronave (AKKP-së në Tiranë). Për këtë të fundit shprehim mjaft ankesa, pasi justifikimi i zyrtarëve të kësaj agjencie ka qenë ndër më absurdët, ku shpeshherë thoshin "që nuk kemi kohë".

Sikur të mos mjaftonte kjo betejë, qeveria merr një vendim, që tokat e këtyre familjeve ia kalon në pronësi Bashkisë së Konispolit dhe tashmë kjo njësi ka të drejtën t'i shesë apo t'i japë me qira.

"Mendohet se në këtë mënyrë, Bashkia e Konispolit pasi t'i regjistrojë këto prona, do t'i nxjerrë për shitje, të cilat do t'i blejnë ata që kanë nxjerrë dhe këtë VKM Nr.17 dt.04/01/2012, që çuditërisht atë ditë nuk ka pasur mbledhje qeverie. Kjo mund të quhet mënyra moderne e grabitjes së pronave", thotë shoqata e "Pronarëve Konispol-Stil".

Pronarët drujnë se tokat e tyre do të përfundojnë në pronësi të dikujt tjetër, me çmime qesharake, si rasti i shpronësimit të rrugës Sarandë-Kranë-Konispol, për 56 lekë metri katror. (faqja 8307 e (Fletores Zyrtare). Tashmë me vendimin në dorë, Bashkia e Konispolit ka të drejtën të bëjë çfarë të dojë me tokat, vendndodhja e të cilave konsiderohet një aset me shumë vlerë, pasi prek një pjesë të rivierës joniane dhe e shtrirë mes maleve.

## ***Botuar ne gazeten Telegraf dt 4.03.2012***

### **Bujar Leskaj dhe Adriatik Llalla firmosin marrëveshjen për ndëshkimin e zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi, me qëllim krijimin e një bazë të dhënash për raste të dyshuara korruptive në administratën publike. Në ceremoninë e zhvilluar dje, ishin të pranishëm Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP, z. Adriatik Llalla, të cilët shprehën impenjimin për koordinimin ndërinstitucional për ndëshkimin e zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin publik. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Leskaj, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e veprimit ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit, si edhe u shpreh se “sot po formalizojmë një marrëveshje, e cila tashmë ka nisur të aplikohet në praktikë. Mendojmë se ka çështje konkrete që kanë nevojë për kontroll ndërinstitucional, me qëllim efikasitetin në luftën kundër konfliktit të interesave e fshehjes së pasurisë dhe, në përgjithësi, kundër veprimeve abuzive të zyrtarëve me pushtetin publik”. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP, z. Llalla, e cilësoi Marrëveshjen si një moment shumë të rëndësishëm në aktivitetin ndërinstitucional.